

**RREGULLORE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE  
NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE  
NË AUTORITETIN SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEHAPËSINOR**

*Miraturar me Vendimin nr. 8, datë 25.06.2015, të ndryshuar me Vendimin nr. 5,  
datë 11.12.2019*

**Drejtori i Përgjithshëm  
Z. Lorenc ÇALA**



## **KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Baza ligjore**

Rregullorja "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor", bazohet në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse, të miratuara në bazë të tyre.

### **Neni 2 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është deklarimi dhe mbajtja e përgjegjësive për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, si dhe garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut nga zyrtarët publikë të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (më poshtë ASIG), si dhe ushtrimi i funksioneve nga punonjësit e ASIG jo në kushtet e konfliktit të interesave.

### **Neni 3 Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për zbatimin e detyrimeve ligjore për deklarimet e pasurive, si dhe identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

### **Neni 4 Përkufizime**

1. "Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në ASIG.
2. "Person i lidhur me një zyrtar të ASIG është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore me zyrtarin, sipas pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, në lidhje me nenin 5, të po këtij ligji.
3. "Parim i proporcionalitetit", sipas pikës 12, të nenit 3, të ligjit 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një



zyrtari me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetiake.

### **Neni 5**

#### **Fusha e zbatimit**

Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zyrtar sipas kuptimit të këtij termi në pikën 1 dhe 2 të nenit 4, të kësaj rregulloreje, kur ai merr pjesë në një vendimarrje për akte e kontrata administrative, si dhe akte normative, dhe konkretisht nga:

- Titullari i institucionit;
- Drejtorët e Drejtorive;
- Përgjegjësit e Sektorëve;
- Specialistët në çdo sektor;
- Çdo zyrtar tjetër i administratës së ASIG;
- Personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar dhe në nenin 30, të Kodit të Procedurave Administrative, sipas situatave të konflikteve të interesit që paraqiten.

### **Neni 6**

#### **Vendimarrja dhe çastet paraprake të vendimarrjes**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, në përputhje me Udhëzimin e ILDKPKI-së nr. 239, datë 2.2.2006, "Për kuptimin e çasteve paraprake dhe thelbësore në një vendimarrje" dhe nenit 4/2 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar:

- a) vendimarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
- b) vendimarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:
  - i) hartimi i projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimi organit apo zyrtarit kompetent për vendimarrje;
  - ii) dhënie e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, për këtë projektakt nga zyrtarë të tjerë, brenda ose jashtë institucionit;
  - iii) dhënie e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;
  - iv) dhënie e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
  - v) përfshirje e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet,

strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative, pa praninë e të cilave nuk do të vendosej dhe mbështetej përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projektkontratës në tërësinë e tyre;

vi) çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së ASIG-ut.

### Neni 7

#### Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 6 të rregullores, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:

a) roli urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;

b) zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht, por jo vetëm, me të dhëna sensitive për biznesin, të dhëna për tatimet e doganat, kuadrin rregullator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes, informacione për politikën ekonomike vendore dhe administrimin financiar;

c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të ASIG-ut.

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i ASIG-ut, si dhe nga zyrtarët eprorë në ASIG.

4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të vetëdeklarojë paraprakisht, në zbatim të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji. Vetëdeklarimi bëhet nëpërmjet plotësimit të dokumentit tip për deklarime të këtij lloji.

5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

### Neni 8

#### Interesat privatë

1. Interesat private të një zyrtari janë interesat që parashikohen nga neni 5, i ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe konkretisht:

a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre;

b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;

c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;



- ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
- d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
- dh) marrëdhënie:
- i) familjare apo të bashkëjetesës;
  - ii) të komunitetit;
  - iii) etnike;
  - iv) fetare
  - v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
- e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.
2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367 datë 07.4.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.
3. Nëse në ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005, i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005, i ndryshuar dhe anasjelltas.
4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 9367, datë 07.4.2005, i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4, të nenit 3, të ligjit nr. 9367 datë 07.4.2005, i ndryshuar.

## KREU II

### PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN, REGJISTRIMIN DHE TRAJTIMIN E KONFLIKTEVE TË INTERESAVE

#### Seksioni 1

#### Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave

#### Neni 9

#### Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit

1. Çdo zyrtar, sipas përcaktimit të këtij termi në nenin 5, të kësaj rregulloreje, në ushtrimin e kompetencave ose në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtarët, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni epror. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për një akt. (Aneksi nr. 1)

#### **Neni 10**

##### **Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë**

1. Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit, është:
  - a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijeni;
  - b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.
2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

#### **Neni 11**

##### **Lëshimi i autorizimit nga zyrtari**

1. ASIG vë në dispozicion të zyrtarëve të tij modelin e autorizimit, që këta duhet të lëshojnë, brenda 30 ditëve nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës. (Aneksi nr.2)
2. Autorizimi dorëzohet në autoritetin përgjegjës të ASIG-ut.

#### **Neni 12**

##### **Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave.**

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, dhe kësaj rregulloreje, sipas hierarkisë janë:
  - a) Titullari I institucionit;
  - b) Drejtorët e Drejtorivë
  - c) Përgjegjësit e Sektorëve
  - j) Përgjegjësit e Sektorëve të administratës së Rektoratit të UK-së.



3. Autoriteti përgjegjës në ASIG, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar dhe në nenin 13, të kësaj rregulloreje janë Drejtuesit e Njësive që menaxhon Burimet Njerëzore, si dhe juristi/specialist për burimet njerëzore në institucion.

### Neni 13

#### Detyrat e Autoritetit Përgjegjës të ASIG-ut.

Autoriteti Përgjegjës në ASIG, kryen detyrat sipas Udhëzimit nr. 1, datë 27.06.2014, të ILDKPKI-së. Këto detyra janë si më poshtë:

1. Mbledh nga burime të ligjshme të dhëna për interesat private të zyrtarëve
  - a) Shpërndan dhe administron autorizimet e lëshuar nga zyrtarët në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar. Autorizimi sipas formatit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm, është i detyrueshëm për t'u plotësuar nga çdo zyrtar, i cili kryen një funksion publik dhe nënshkruhet brenda 30 ditëve nga data e fillimit të detyrës.
  - b) Në emër të institucionit publik, mbledh të dhëna personale për zyrtarin, kudo që ato janë të regjistruara në regjistrat publikë, të cilat lidhen me interesat private, që mund të krijojnë ose duket sikur krijojnë konflikt interesi me funksionin publik apo detyrat që ushtron zyrtari. Mbledhja e këtyre të dhënave duhet të bëhet në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
2. Propozon nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore, si dhe ndryshimet në rregulloret e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave të institucionit, në përputhje me ligjin e parandalimit të konfliktit të interesave, si dhe udhëzimeve të ILDKPKI-së.
3. Detyrat e Autoriteteve Përgjegjëse për konstatimin, trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave.

Autoriteti Përgjegjës, në emër të institucionit, kryen verifikim dhe hetim administrativ lidhur me interesat private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi, në të gjithë regjistrat publikë apo institucione të tjera duke shfrytëzuar të gjithë mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë eprorin e drejtpërdrejtë deri tek titullari i institucionit:

- a) Autoriteti Përgjegjës, pranon informacion të ofruar nga zyrtarë të tjerë apo persona të interesuar, të siguruar në mënyrë të ligjshme dhe verifikon/kontrollon burimin dhe vërtetësinë e këtyre të dhënave.
- b) Në bazë të informacionit të grumbulluar, Autoriteti Përgjegjës, bazuar në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, vlerëson nëse rasti konkret përbën konflikt interesi, duke analizuar njëkohësisht dhe rolin dhe kompetencat e zyrtarit në procesin vendimmarrës.
- c) Verifikon dhe vlerëson, nëse nga situata e konstatuar në kushte të konfliktit të interesit, kanë ardhur pasoja.
- d) I komunikon vetë zyrtarit dhe eprorit, të dhënat e mbledhura dhe shkeljet e konstatuara, duke i orientuar gjithashtu për masat që duhet të marrë vetë zyrtari apo eprori për zgjidhjen e konfliktit, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 37 dhe 38, të ligjit nr.9367, date 7.4.2005, i ndryshuar.
- e) Plotëson dhe administron regjistrin e konfliktit rast për rast të interesit, i cili duhet të përmbajë të dhëna lidhur me:
  - i) Identitetin e zyrtarit;



- ii) Interesat privatë të tij, të cilët janë bërë shkak për një konflikt interesi;
  - iii) Thelbin e konfliktit;
  - iv) Palët e interesuara;
  - v) Burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe verifikimit të tyre;
  - vi) Vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprorë ose nga gjykatat;
  - f) Mbështet eprorin, sipas rastit, për marrjen e masave disiplinore dhe raporton rastin në ILDKPKI për ndjekje të mëtejshme.
4. Rregullimi i pasojave juridike, pavlefshmëria e akteve/kontratave administrative të marra në kushtet e konfliktit të interesave
- 4.1 Autoriteti Përgjegjës në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse, e cila trajton çështjet juridike:
- a) Merr masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara, në lidhje me aktet e marra në kushtet e konfliktit të interesit.
  - b) Siguron transparencën me publikun lidhur me vendimmarrjet e kryera nga institucioni përkatës dhe zbatimin me korrektësi të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- 4.2 Shtron çështje dhe kërkon këshilla nga ILDKPKI, për zbatimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, si dhe përmirësime në ligje të tjera, kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;
- 4.3 I propozon me shkrim organit kompetent (eprorit /institucionit epror) revokimin/shfuqizimin e akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesave.
- 4.4 Në rastet e konstatimit të pavlefshmërisë së një akti/kontrate administrative të institucionit publik, sipas përkufizimit të këtij termi në Kodin e Procedurave Administrative, si pasojë e nxjerrjes së tyre në kushtet e konfliktit të interesave (faktik apo në dukje), Autoriteti Përgjegjës, në bashkëpunim me strukturën përkatëse, në zbatim të nenit 40/1, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, kur gjykon se zyrtari ka vepruar me keqbesim:
- a) I propozon eprorit/organit kompetent fillimin e procedurave të dënimit disiplinor ndaj zyrtarit, përgjegjës për pavlefshmërinë e aktit;
  - b) Propozon të ndërmerren procedurat për kalimin e barrës së dëmshpërblimit te ky zyrtar;
  - c) Inicion fillimin e procedurave të ankimit pranë organit gjyqësor, për vendosjen e një shpërblimi në favor të institucionit për dëmin moral të shkaktuar;
  - d) Propozon të bëhet kallëzim penal ndaj zyrtarit, nëse gjykohet se shkelja e kryer nga ai përbën vepër penale;
- Këto masa të sipërcituara, mund të zbatohen edhe ndaj çdo zyrtari tjetër përgjegjës, që me veprimet apo mosveprimet e veta nuk ka parandaluar konfliktin e interesit, shkak për pavlefshmërinë e aktit, ose për moszbatimin e detyrimeve për shmangien e konfliktit të interesave të përcaktuara në ligj.
5. Roli këshillues dhe trajnues i Autoriteteve Përgjegjëse
- a) Autoriteti Përgjegjës i sugjeron zyrtarëve dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e konfliktit të interesit rast për rast ose të vazhdueshëm (faktik, në dukje dhe i mundshëm).
  - b) Mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e



gjobave nga ILDKPKI, në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

c) Përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;

d) Merr masa për të siguruar aksesin dhe informimin e publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit.

#### 6. Detyrat e Autoriteteve Përgjegjëse në procesin e deklarimit

a) Autoriteti Përgjegjës në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 3 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, duhet të përgatisë listën e përditësuar të zyrtarëve, të cilët, në varësi të funksionit që kryejnë, mbartin detyrimin për deklarim të interesave private dhe të dërgojë kopje të saj në ILDKPKI;

b) Në rastet e emërimeve dhe largimeve të zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim, duhet të njoftojë menjëherë me shkrim ILDKPKI, lidhur me datën e emërimit/largimit të subjekteve.

c) Orienton dhe udhëzon zyrtarët, të cilët mbartin detyrim për deklarim, për plotësimin në rrugë elektronike (me kompjuter) të deklaratës së interesave private, sipas llojeve (Para fillimit të detyrës, Periodik vjetor, Pas largimit nga funksioni);

d) Informon zyrtarët lidhur me afatet ligjore, brenda të cilave plotësohet dhe dorëzohet deklaratat e interesave private;

e) Informon zyrtarët lidhur me sanksionet në rast refuzimi për plotësim të deklaratës, në rast mosplotësimi brenda afatit, si dhe në rastin e deklarimeve të rreme;

f) Jep asistencë, nëse kërkohet nga ana e zyrtarëve, në plotësimin e deklaratave;

g) Mban databazë për shpërndarjen dhe dorëzimin e deklaratave të interesave private të zyrtarëve dhe pasi verifikon se dokumenti zyrtar është pa mangësi, lëshon për subjektin vërtetimin e marrjes në dorëzim.

h) Mbledh deklaratat e plotësuara nga zyrtarët (subjekte të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, dhe i dërgon pranë ILDKPKI, sipas listës emërore të dorëzimeve.

i) Përgatit jo më vonë se data 31 Janar e vitit pasardhës, raportin vjetor mbi veprimtarinë e kryer dhe e dërgon në ILDKPKI.

#### 7. Raportimi vjetor mbi veprimtarinë e Autoriteteve Përgjegjëse

Në zbatim të pikës 3, të nenit 42, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, Autoritetet Përgjegjëse i paraqesin Inspektoratit të Lartë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarimin periodik.

Raporti vjetor duhet të përmbajë:

a) Për procesin e deklarimit të interesave private periodike:

i) njoftimin, dhënien e konsulencës dhe dorëzimit të deklaratave të interesave private nga zyrtarët, si dhe respektimin e afateve ligjore nga ana e tyre.



- ii) Rakordimi i listës së zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarimin e interesave private.
  - iii) Evidentimi i rasteve të mosrespektimit të afateve ligjore për dorëzimin e deklaratave të interesave private.
  - iv) Evidentimi i marrjes së masave disiplinore për shkelje të konstatuara të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar dhe ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.
- b) Për identifikimin dhe regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave:
- i) Plotësimin e autorizimit për parandalimin e konfliktit të interesave nga çdo zyrtar;
  - ii) Identifikimin, regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave.
  - iii) Raste të verifikuara dhe kontrolluara për konflikt interesi.
  - iv) Raste të trajtuara dhe të zgjidhura të konfliktit të interesave.
  - v) Raste të pazgjidhura të raportuara në ILDKPKI, gjykatë, prokurori.
8. Përgjegjësitë e Autoriteteve Përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave
- a) Autoriteti Përgjegjës, duhet të respektojë gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së tij (edhe pas largimit të zyrtarit nga funksioni), parimet e konfidencialitetit dhe besueshmërisë në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” I ndryshuar.
  - b) Në rastet kur konstatohen shkelje të detyrimeve ligjore nga kjo strukturë, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, i propozon titullarit të institucionit masë disiplinore, në zbatim të pikës 3, të nenit 45, të ligjit nr.9367, si dhe ndërmerr procedurat për vendosjen e masave administrative “gjobë”, në zbatim të nenit 44, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.
9. Kryerja e detyrave dhe ushtrimi i kompetencave nga ana e autoriteteve përgjegjëse në funksion të parandalimit të konfliktit të interesave, duhet të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### Neni 14

#### Administrimi i dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës

1. Dokumentacioni i përdorur nga autoriteti përgjegjës, në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar dhe në zbatim të kësaj rregulloreje, është dokumentacion zyrtar. Zyrtari/ët e emëruar si autoritet përgjegjës, me rastin e emërimit dhe largimit të tij/tyre duhet të marrë/marrin në dorëzim zyrtarisht nga Dega e Burimeve Njerëzore & Protokoll Arkivës dhe të bëjë/bëjnë dorëzimin e plotë të dokumentacionit pranë kësaj dege, e cila më pas ia dorëzon zyrtarit/ëve të rinj që marrin detyrën e autoritetit përgjegjës.
2. Me qëllim administrimin sa më të mirë të dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës, krijohen dhe mbahen nga ky autoritet përgjegjës dosje të veçanta me përmbajtje si vijon:

- Dosja nr. 1, me titull “Për aktet ligjore & nënligjore” duhet të përmbajë:

- Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;



- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të disa të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
  - Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
  - Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
  - Ligjin nr. nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
  - Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
  - Ligje të tjera që lidhen me veprimtarinë e institucionit publik;
  - Komentarët ligjorë nr. 1, 2, 3, 4, 5 (dhe të tjerë që miratohen në vijimësi) të ILDKPKI-së;
  - Manuale shpjegues dhe trajnimi nr. 1, 2, 3, 4 (dhe të tjerë që miratohen në vijimësi) të ILDKPKI-së;
  - Urdhra dhe udhëzime të ILDKPKI-së, ose të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim, si për shembull:
    - Udhëzimi nr. 7, datë 21.2.2006 “Për funksionet që mbartin detyrimin për deklarin”;
    - Udhëzimi nr. 239, datë 2.2.2006 “Për kuptimin e çasteve paraprake dhe thelbësore në një vendimmarrje”;
    - Udhëzimi nr. 1, datë 27.06.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike”;
  - Urdhri nr. 27, datë 13.03.2014 i ILDKPKI-së;
  - Urdhri nr. 28, datë 13.03.2014 i ILDKPKI-së;
  - Urdhri nr. 29, datë 17.03.2014 i ILDKPKI-së.
- Dosja nr. 2 me titull “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave” duhet të përmbajë:
    - Regjistri i konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri, i sekretuar;
    - Autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
    - Deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
    - Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
    - Verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë.
  - Dosja nr. 3 me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe interesave të zyrtarëve që kanë detyrimin për deklarin pranë ILDKPKI-së” duhet të përmbajë:
    - Regjistrin themeltar alfabetik, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKPKI;
    - Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarin dhe konfirmimet e tyre;
    - Kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI;
    - Kopje të formularit për listën e zyrtarëve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;

- Librin për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit.

#### **Neni 15**

#### **Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave**

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të ASIG-ut, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga autoriteti përgjegjës i ASIG-ut dhe respekton formën tip të miratuar nga ILDKPKI. (Aneksi nr. 3)

#### **Neni 16**

#### **Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit**

Autoriteti përgjegjës, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesi, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose nga gjykatat.

#### **Seksioni 2**

#### **Identifikimi, regjistrimi, kufizimi i interesave privatë dhe trajtimi i rasteve me konflikt interesi**

#### **Neni 17**

#### **Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklaram periodik të interesave privatë**

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve, bëhet sipas kërkesave të kreut I, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
2. Zyrtarët e ASIG-ut, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarime periodike të interesave private sipas nenit 3, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, janë:
  - a) Titullari i institucionit;
  - b) Drejtorët e Drejtorive;
3. Në përputhje me nenin 7, pika 5, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, kanë detyrim për deklaram të pasurive dhe detyrimeve financiare periodike edhe bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni.

#### **Neni 18**

#### **Llojet e interesave privatë, që deklarohen periodikisht**

Interesat privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë që deklarohen periodikisht, janë të përcaktuara në nenin 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe të renditura më poshtë:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;



- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 (treqindmijë) lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;
- dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
- e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;
- ë) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.
- f) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;
- g) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijojnë të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim;
- gj) interesa privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës;
- h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.

### Neni 19

#### **Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta**

1. Sipas ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, neni 21, pika 1, asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2, të ligjit të mësipërm dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm, të parashikuar në nenin 31, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, ndalimi sipas paragrafit të parë, të kësaj pike, për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuar në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Në ASIG, zyrtarët, që përfshihen në dispozitën e mësipërme janë si vijon:

- Titullari i institucionit - në cilësinë e zyrtarit të nivelit të lartë;
- Drejtorët e Drejtorive - në cilësinë e zyrtarëve të nivelit të mesëm;

2. Pavarësisht përcaktimeve të bëra në pikën 1, të këtij neni të rregullores, bazuar në pikën 3, të nenit 21, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet një



institucioni publik apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë, nga njëra anë dhe një individ, personi fizik a juridik apo ndonjë formë tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur plotësohen, njëkohësisht, kushtet e mëposhtme:

- a) zyrtari, që ushtron funksionet në këtë institucion publik (në rastin konkret ASIG) ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në përcaktimin e termave të kontratës;
- b) ky zyrtar ka një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, apo të nenit 709 të Kodit Civil, ose ka një interes të llojit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Sipas pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, nga ndalimet e pikave 1 dhe 3, të po këtij neni të ligjit, përjashtohen rastet kur lidhja e kontratës:

- a) ka të bëjë me punësimin e vetë zyrtarit në institucion publik (në rastin konkret ASIG) ose me statusin e tij ligjor;
- b) ka të bëjë me marrjen nga zyrtari të një shërbimi, që ofrohet nga institucioni publik (në rastin konkret ASIG) ose organizmat dhe subjektet e krijuara a nën kontrollin e institucionit publik, kur këto shërbime janë të parashikuara në objektin e veprimtarisë së institucionit publik, si dhe me kushtin që shërbimi nuk i jepet zyrtarit në mënyrë favorizuese apo si trajtim preferencial në raport me të tjerët;
- c) bazohet në ligje të veçanta, për qëllime publike, ose për trajtime të posaçme të kategorive të ndryshme të zyrtarëve;
- ç) është e domosdoshme për kryerjen e funksionit publik dhe nuk ka alternativë tjetër;
- d) ka të bëjë me një dhuratë, favor ose trajtim preferencial, në çdo rast pa kundërshpërblim, që subjektet e përcaktuara në pikën 1 shkronjat “a” dhe “b” dhe në pikën 2 të këtij neni, bëjnë në favor të një institucioni publik.

Për rastin përjashtimor të shkronjës ç, të kësaj pike, bazuar në pikën 5, të nenit 21, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, institucioni publik (në rastin konkret ASIG), që lidh kontratën, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë funksionimin e tij:

- a) kërkon pëlqimin e institucionit më të afërt epror;
- b) njofton Inspektoratin e Lartë dhe e bën këtë kontratë publike në mungesë të institucionit apo kur marrja e pëlqimit bie ndesh me parimin e pavarësisë së institucioneve.

4. Sipas ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, neni 22, pika 2, zyrtarit, që është përfaqësues i një institucioni publik në zotërimin e aksioneve ose të pjesëve në kapital të shoqërive tregtare, gjatë ushtrimit të këtij funksioni i ndalohet:

- a) marrja drejtpërdrejt ose tërthorazi, me ndërmjetësimin e palëve të treta, e çdo përfitimi financiar, përfshirë krijimin e një burimi të ardhshëm financiar, që lidhet ose përfitohet për shkak të detyrës së tij si përfaqësues;
- b) pranimi, në favor të tij, i dhuratave ose pjesëve në kapital nga shoqëria, anëtarët ose organet e saj;
- c) blerja e pjesëve në kapital, aksioneve ose pasurive të këtyre shoqërive;
- ç) përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga furnizues apo klientë të këtyre shoqërive.

5. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarët, të përcaktuara më lart, zbatohen edhe për personat e lidhur me ta, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e



zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 24 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, I ndryshuar.

### **Neni 20**

#### **Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit të vazhdueshë të interesit për raste të veçanta**

1. Sipas ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, neni 31, zyrtarët e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues sipas legjislacionit të shërbimit civil, të barasvlershëm me zyrtarët në pozicionet drejtor I përgjithshëm dhe drejtor drejtorie, në ASIG;

a) nuk mund të jenë drejtues në organizatat fitimprurëse;

b) nuk mund të jenë anëtarë në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse, kur këta ushtrojnë veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, me akte, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri a organizata apo mbi shoqëri ose organizata të tjera që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, përjashtuar rastet kur ky pozicion në shoqëri ose organizatë vjen për shkak të funksionit dhe/ose të statusit;

c) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licensuar, si dhe të konsulentit, agjentit a të përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni, dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

ç) mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, pa asnjë kufizim, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri apo mbi shoqëri të tjera, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, rast në të cilin zyrtari mund të zotërojë aksione ose pjesë në kapital vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjën “c” të nenit 27 të këtij ligji.

2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarët, të përcaktuara më lart, zbatohen edhe për personat e lidhur me ta, sipas përcaktimeve të nenit 35, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

### **Neni 21**

#### **Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale**

1. Është e ndaluar që një zyrtar I ASIG të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, nga subjekte të deklarimit të interesave private periodike në ILDKPKI, kur kjo



mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës, a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

- a) “Dhurata”, sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;
  - b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.
2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.
  3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlere simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e zyrtarit.
  4. Vlerësimi dhe trajtimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;
  5. Në asnjë rast zyrtari i ASIG-ut nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
  6. Përfshihen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.
  7. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarët, të përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për personat e lidhur me ta, sipas pikës 1 e 2, të nenit 24, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

## Neni 22

### Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

1. Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët e ASIG bëhen sipas kreut IV, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.
2. Disa nga mënyrat bazë të mënjanimi të konfliktit të interesit janë:
  - T’i kufizohen zyrtarit informacione të caktuara, që lidhen me ushtrimin e funksionit të tij;
  - Të mos i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti interesash;
  - Të mos lejohet që zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;
  - Të rishikohen ose të ndryshohen detyrat dhe kompetencat e zyrtarit;
  - Të transferohet zyrtari në një detyrë tjetër, që shmang konfliktin e interesave;
  - Të merren masat e nevojshme për të shmangur emërimin ose zgjedhjen e një zyrtari në funksione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash;
  - Në rast të një akti të marrë në praninë e konfliktit faktik të interesit, në çdo mënyrë që kjo vihet re, të anulohen ose të revokohen aktet e marra nga zyrtari, sa më parë që të jetë e mundur, dhe mundësisht para se ato të kenë sjellë pasoja;



- Anulimi ose revokimi i aktit mund të bëhet edhe kur gjykohet se akti është marrë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme;
- Anulimi ose revokimi i një akti nuk bëhet nga eprori i zyrtarit, kur ai vlerëson se pasojat që mund të vijnë nga anulimi ose revokimi i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anulim ose revokim.

### **Neni 23 Sanksionet**

Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar dhe ligjin nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, përbëjnë sipas rastit shkelje disiplinore, kundërvajtje administrative apo vepër penale, dhe ndëshkohen sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

### **Neni 24 Mbrojtja për dhënien e informacioneve**

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e ASIG-ut, përfiton mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:
  - a) zyrtari, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
  - b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.
2. Nga parashikimi i pikës 1 (b) të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - a) kur zyrtari:
    - i) ose është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
    - ii) ose vetëpërjashtimi i zyrtarit është i pamundur, sepse është i pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit te një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;
    - iii) ose për shkak se asnjëra nga zgjidhjet e parashikuara në nenin 24, pika 2, të kësaj rregulloreje nuk është e mundur;
  - b) dhe kur:
    - i) vendimet e zyrtarit, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;
    - ii) nuk është i mundur as transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);
    - iii) nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga eprori ose nga institucioni epror, të ngarkuar me

ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen publike.

#### **Neni 25**

##### **Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës**

1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të ASIG-ut, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt, që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, apo ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, si dhe ligjet e posaçme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e ASIG-ut.
2. Në çdo rast që specifikimet në këtë rregullore, bien ndesh me dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre, këto të fundit kanë prioritet dhe zbatohen drejtpërdrejt. Gjithashtu, dispozitat e këtyre ligjeve dhe akteve nënligjore zbatohen drejtpërdrejt, për aq sa nuk ka specifikime në zbatim të tyre në këtë rregullore.

#### **Neni 26**

##### **Njoftimi i rregullores punonjësve dhe trajnimet për rregulloren**

1. Rregullorja i bëhet e njohur çdo punonjësi të institucionit nëpërmjet dërgimit në postën elektronike zyrtare, si dhe dhënies së një kopjeje të saj, secilit punonjës të punësuar në kohën e miratimit të saj apo në momentin që punësohet në institucion.
2. Drejtoria përgjegjëse për burimet njerëzore merr masa për njohjen e saj nga çdo zyrtar, dhe nëpërmjet trajnimeve në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, jo më vonë se një muaj nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.
3. Drejtoria përgjegjëse për burimet njerëzore, pas miratimit të kësaj rregulloreje përgatit materiale informuese për njohjen e saj, të cilat i shpërndahen cilitdo punonjësi të institucionit dhe vihet në dispozicion të publikut pa kërkesë, në përputhje me ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

#### **Neni 27**

##### **Hyrja në fuqi, shpallja**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë me miratimin e saj.
2. Kjo rregullore, menjëherë me miratimin e saj, publikohet në faqen zyrtare të internetit të ASIG-ut.



**DEKLARIM**  
***RAST PAS RASTI I INTERESAVE PRIVATE TË ZYRTARIT***  
***NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE***

**Kush mbart detyrimin për deklaram rast për rast të interesave private:**

Të gjithë zyrtarët e përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 si dhe në Rregulloren e Brendshme të institucionit.

**Llojet e deklaramit:**

- 1- Vetdeklaram paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesave private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konfliktit të interesit
- 2- Deklaram rast për rast të interesave private të një zyrtari kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror.

**Të dhëna personale:**

Emri – Atësia – Mbiemri – Funkzioni – Institucioni  
\_\_\_\_\_

Lloji i deklaramit: (vendos X në kutizën për llojin e deklaramit);

Me kërkesë të \_\_\_\_\_

Vetdeklaram

**Vërtetohet se deklaramet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.**

1- Përshkrimi i hollësishëm i interesave private që bëhen shkak për një konflikt të interesit:

\_\_\_\_\_

2- Përmbajtja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt të interesit:

\_\_\_\_\_

3- Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

\_\_\_\_\_

Data e dorëzimit të deklaramit \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**A U T O R I Z I M**

Unë, i nënshkruari, \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër)

me funksion \_\_\_\_\_  
(emërtimi i funksionit dhe institucionit publik)

në datën \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, në respekt të detyrimit tim ligjor sipas nenit 10 pika 2 dhe nenit 41 pika 2 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, autorizoj institucionin ASIG – Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për personin tim, kudo ku ato janë të regjistruara dhe që lidhen me llojet e interesave private të përcaktuara në nenin 5, me përjashtim të atyre të dhënave vetjake të përcaktuara në pikën 4 të nenit 7 të këtij ligji.

Ky autorizim ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror.

Autorizimi ka vlerë për të gjithë kohën që unë ushroj detyrën publike, e cila është subjekt i kontrollit dhe i verifikimit sipas ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Gjithashtu, ky autorizim ka vlerë për çdo kohë, pavarësisht nga mosvazhdimi i detyrës sime publike, por vetëm për ato të dhëna të interesave të mia private, të cilat mund të lidhen me ushtrimin e detyrës publike në kohën e ushtrimit të saj.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna personale, të kryera nga institucionet, ose personat e autorizuar prej tij, i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Çdo person fizik ose juridik, publik ose privat, nuk duhet t’u nxjerrë pengesë personave konkretë që posedojnë origjinalin ose kopjen e njehsuar me origjinalin të këtij autorizimi e të ngarkuar zyrtarisht, sipas ligjit për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna të interesave të mia private.

Në bazë të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, personi i ngarkuar për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave, që vihet në dijeni për të dhënat personale të autorizuesit, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara në ligj.

**AUTORIZUESI**

**TITULLARI I INSTITUCIONIT**



**INSTITUCIONI: AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR – ASIG****REGJISTRI I KONFLIKTIT RAST PËR RAST TË INTERESIT, VITI \_\_\_\_\_**

Nr.	EMRI . ATESIA . MBIEMRI	Interesat private, shkak për konfliktin e interesit	Thelbi i konfliktit	Palët e interesuara	Burimi i të dhënave, mënyra e marrjes dhe verifikimit të tyre	Vendimmarrjet
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						

Autoriteti Përgjegjës:

---

---